

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM DEZINFEKTIMI, DERATIZIMI DHE DEZINSEKTIM PËR DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR GRAMSH”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 2455000-8, 33631600-8.

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,232,130 (tre milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë) **Lekë (pa TVSH).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DT;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DT;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Liçencë për kategorinë II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në fushën objekt prokurimi. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jete i licensuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nen ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe *me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si me poshtë:

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- Diplomë me profesion Shëndet Publik /Biologji/Kimi.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e leshuar nga e - albania.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune.
- Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklarata perkatese.

b) **Minimalisht 2 (dy) persona,** sipas profileve të mëposhtme:

- specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- specialistë për kryerjen e kalibrimit të pajisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- Për punonjësit e përcaktuar në pikën b) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, dëshmon se punonjësit do të jenë të pajisur me Certifikatë për kryerjen e trajnimeve në fushën DDD (pra, të jenë të siguruar sipas kërkesave ligjore në fuqi).

➤ Operatori ekonomik të paraqes deklarata në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Shënim 1:

Me qëllim garantimin e gjithë përfshirjes, për të dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën perkatese të prokurimit, punonjësit e mesiperm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik nënkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë shërbimet e dezinfektimit është e nevojshme pasja e një stafi të kualifikuar. Stafi i kërkuar, është përcaktuar edhe nga vete autoriteti kontraktor, ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në nevojën për kryerjen e shërbimeve si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen në përpjestim të drejtë edhe me sipërfaqen që do të kryhet shërbimi dhe fondin limit perkatese të procedurës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës për realizimin e objektit. Operatori ekonomik duhet të disponojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të

rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit DDD pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh natyrën e shërbimit janë kërkuar edhe punonjes në rolin përgjegjës dhe specialistet përkatës sipas fushës së përcaktuar objekt prokurimi me qëllim organizimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve në terren sipas zonave të caktuara referuar kushteve dhe standarteve teknike. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Staf i kërkuar duhet të jetë i kualifikuar dhe me experience në fushën e objektit të prokurimit.

- Operatori ekonomik në lidhje me lenden e përcaktuar në specifikimet teknike, që do të paraqesë, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe Certifikatë konformiteti ose cilësi CE/ekuivalent.

Lenda që do të përdoret në shërbimin e dezinfektimit			
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësi CE/ekuivalent
1			
2			
3			

Shënim:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK certifikatat e cdo produkti.

Te dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qene pjese e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion lendet e para të certifikuara sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Duke qenë se në zonën bregdetare kemi të pranishme zona të mbrojtura nga konventat kombëtare dhe ndërkombëtare, rekomandohet kontrolli biologjik i larvave me anë të agjentëve biologjik pra **përdorimi i produkteve me lëndë aktive Bti** (*Bacillus thuringensis israeliensis*), lende të cilat janë të përshtatshme për kryerjen e shërbimit të dezinfektimit.

- Operatorët ekonomikë me ane të një deklaratë, duhet të marrin përsipër se për secilin produkt (objekt prokurimi) duhet të shoqërohet me etiketën dhe elementët përkatës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Produktet Biocide me përmbajtje të lëndëve aktive të cilat do të përdoren për kryerjen e shërbimit DDD objekt prokurimi trajtohen sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së

dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”; Per kerte arsye kërkohet qe produktet te shoqërohen me etiketën me elementet te përcaktuar sipas VKM 933/2020 me qellim evidentimin dhe garantimin e sigurisë se produktet qe do te perdoren do te jene konform ligjit dhe standarteve ne fuqi.

5. Operatoret ekonomike me ane te një deklarate, duhet te marrin përsipër, se me nënshkrimin e kontratës, duhet te paraqes për çdo produkt, raport-testimet si dhe certifikimet përkatëse, te cilat duhet te jene sipas përcaktimeve te specifikimeve teknike te AK, te lëshuara nga organet kompetente te akredituara.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

6. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se **disponon, pajisjet dhe mjetet**, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1.	Pompë me presion	copë	2	Në pronësi ose me qira
2.	Cantë shpine me presion	copë	2	Në pronësi ose me qira

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nisur nga natyra e shërbimit, sipërfaqja, grafiku i ekzekutimit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Llojet e makinerive dhe pajisjeve te nevojshme per kryerjen e këtij shërbimi janë përcaktuar nga vete autoriteti kontraktor, numri i tyre eshte përcaktuar ne përpjesëtim te drejte me sipërfaqen ku do te kryhet shërbimi si dhe fonditi limit.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se, produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, janë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratatë të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Data e publikimit të njoftimit është 03.11.2022 dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **14/11/2022 ora: 11:00** në faqen e internetit www.app.gov.al, në Ministrinë e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.